



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-15923/20 datë: 19.08.2020



Npi – 01/175 Datë: 31.08.2020

Bazuar në nenin 40.2.d, si dhe neni 58 pika (j), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenit 45.4 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048, si dhe mbi bazën e prezentimit të Raportit finaciar për gjashtë mujorin e parë të vitit 2020, nga Zyra Komunale për Financa, Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më: 31.08.2020, mori këtë:

V E N D I M

**PËR APROVIMIN E RAPORTIT BUXHETOR TË KOMUNËS SË SHTIMES
PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2020**

I

Kuvendi Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VI- të rregullt për vitin 2020, të mbajtur më datën: 31.08.2020 me shumicën e votave aprovoi, Raportin Buxhetor të Komunës së Shtimes për periudhën, Janar – Qershor 2020.

II

Raporti finaciar për gjashtë mujorin e parë të vitit 2020, është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Zyrës për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushteti Lokal, Ministrisë për Financa, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj